



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 11781 Prot.

6

Patos më 04.12.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 27.11.2024

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Elmira Rama
2. Vjollca Kasaj
3. Suela Hoxhaj
4. Albiona Lamaj
5. Erald Çepele
6. Ertilla Myrtaj
7. Klarida Semanjaku
8. Klaudio Alisininaj
9. Lori Musaj
10. Artan Velçani
11. Armand Ahmetaj
12. Smerald Hazizaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar specialist të administratës!

Të nderuar qytetar!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53 pika 4 neni 56 pika 2 gërma a.

Dua tju informoj se rendi i ditës është hartuar konform rregullave dhe ligjit që sapo përmëndëm Kourumi është me 12 këshilltarë.

Kalojmë në rendin e ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.10.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.10.2024.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Tetor 2024”.

5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Tetor 2024".

6- Projekt-vendim "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga "fondi kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" në vlerën 88,000 mijë (tetëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe "fondi i pa kushtëzuar për mbrojtjen civile" në vlerën 47,000 mijë (dyzetë e shtatë mijë) lekë për z. Fatmir Bilaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja "Naftëtari".

7- Projekt-vendim "Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025".

8- Projekt-vendim "Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, Institucioneve në Vartësi dhe të Njësisve Administrative për vitin 2025".

9- Projekt-vendim "Për miratimin e planit të aktiviteteve për vitin 2025, Planin e konsultimeve dhe buxhetit të këshillit bashkiak Patos për vitin 2025".

Dua t'ju njoftoj se për pikat 4, 5, 6, 7, 8 është mbledhur komisioni i Ekonomisë dhe do të na relatoj përpara shqyrtimit të këtyre pikave.


**U shtua dhe një këshilltar ( Z. Zejni Musaj)**

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro abstenim ska, kundër ska.



SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Loni Musaj  
M.P.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 417/81 Prot.  
17

Patos më 04.12.2024

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.10.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë propozim, sygjërim për korrëgjim procesverbali?

Nëse ska pyetje atëherë quhet i ezuaruar pra i miratuar.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR  
Armand Ahmetaj

Lari Musaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4148 / 18  
Prot.

Patos më, 04 12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.10.2024

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 28.10.2024 janë marrë gjithsej 7 vendime. Nga nr. 72 deri në nr 78.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim. Nga keto vendime nuk kishte ndonjë akt normativ për të përcjell në Prefekturë.

Faleminderit!

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Smerodol Hoxhaj  
Glabrisma Lamaj

KRYETAR  
Armand Ahmetaj

Lori Musaj  
uf.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4167 Prot.  
13

Patos më 04.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Tetor 2024.

Siç e theksova dhe më para kjo pikë ka kaluar më para për diskutim dhe votim në komisionin e Ekonomisë. Pra janë ezauruar brenda komisionit. Nëse duhet që specialisti përkatës të raportoj, nëse jo kalojmë në votim menjëherë.

Armand Ahmetaj –Atëherë kalojmë në votim pikën katër Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Tetor 2024”.

Kush është dakord për pikën e katërt?

Miratohet me 13 vota pro, kundër ska, abstenim ska.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Smerolal Hoxied  
Albisma Lomaj

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4165/13 Prot.

Patos më 04 12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Tetor 2024”.

Të njejtën situatë kemi si në pikën e kaluar, nëse skemi ndonjë pyetje apo sygjërim tjetër sygjëroj të kalojmë në votimin e kësaj pike

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Loni Musaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3865 / Prot.  
16

Patos më 04 .12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “fondi kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” në vlerën 88,000 mijë (tetëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe “fondi i pa kushtëzuar për mbrojtjen civile” në vlerën 47,000 mijë (dyzetë e shtatë mijë) lekë për z. Fatmir Bilaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “Naftëtari”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin.

Arben Shpërdheja-Relacion për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “fondi i kushtëzuar i buxhetit të shteti për mbrojtjen civile” në vlerën 88,000 mijë (tetëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe “fondi i pa kushtëzuar për mbrojtjen civile” në vlerë 47,000 mijë (dyzetë e shtatë mijë) lekë për z. Fatmir Bilaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “Naftëtari”.

Z. Fatmir Bilaj, banor i lagjes “Naftëtari” Patos, ka paraqitur kërkesën me Nr. 3865 prot., datë 21.10.2024, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë në lagjen “Naftëtari” nga rënia e zjarrit si dhe ka kërkuar ndihmë për rehabilitimin e saj.

Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me Urdhërin nr. 259, nr. 3865/1 prot., datë 22.10.2024

Komisioni pasi bëri verifikimin në vend të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Fatmir Bilaj mbajti procesverbalin me nr. 3865/2 prot., datë 24.10.2024.

Nga procesverbali i verifikimit në vend rezulton se janë djegur : dyer të brendshme tamburate të rimesuara të banesës 3.2 m<sup>2</sup>, dyer druri 1.8 m<sup>2</sup>, dyer d/alumini me mbushje element 2.6 m<sup>2</sup>, dritare metalike 3.9 m<sup>2</sup>, suvatime muresh dhe solete 82 m<sup>2</sup>, lysterje me hidromat 205 m<sup>2</sup>, lavatricja, bufe, frigorifer, sobë, divan, dhe orendi të tjera. Për dëmet e shkaktuara nga zjarri është hartuar edhe preventivi për punimet që duhet të kryhen në banesë në vlerën 276,520.6 ( dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzetë pikë gjashtë) lekë.

Referuar “Vërtetimit për rënie zjarri” nr. 11 të datës 21.10.2024, lëshuar nga MZSH Patos që vërteton rënien e zjarrit, procesverbalit të mbajtur në vend nr. 3865/2 prot., datë 24/10/2024, preventivit të hartuar, bazuar në V.K.M-në nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të pakushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” (i ndryshuar) pika 3.1 shkronja “a” me qëllim për të ndihmuar qytetarin Z. Fatmir Bilaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, t’i jepet një ndihmë financiare në vlerën 88,000 (tetëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe 47,000 (dyzetë e shtatë mijë) lekë do të mbulohet nga fondi i pa kushtëzuar për mbrojtjen civile i Bashkisë. Në total vlera 135,000 (njëqindë e tridhjetë e pesë mijë) lekë. “Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024” është zëzuar.

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen drejtoritë përkatëse

Armand Ahmetaj – Përpara se të kalojmë në diskutime do doja fjalën e kryetarit të komisionit të Ekonomisë pra rekomandimin për Këshillin.

Lori Musaj- Përshëndetje të gjithëve komisioni u mbledh ditën e hënë datë 25 nëntor. Komisioni Ekonomisë pasi shqyrtoj projektvendimin e mësipërm konstaton se përmbajtja e projektvendimit është në përputhje me bazën ligjore dhe e ka miratuar pa asnjë ndryshim duke e votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj – Diskutimet janë të hapura. Kush e do fjalën?  
Nëse s'kemi diskutim tjetër në propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë, Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “fondi kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” në vlerën 88,000 mijë (tetëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe “fondi i pa kushtëzuar për mbrojtjen civile” në vlerën 47,000 mijë (dyzetë e shtatë mijë) lekë për z. Fatmir Bilaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “Naftëtari”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba



Smerald Horriq


KRYETAR

Armand Ahmetaj

Albiona Lomaj



Lori Musaj







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4772 / Prot.  
3

Patos më 04.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”.

Ekzekutivi relatton materialin

Çajup Refitaj – Drejtor i të Ardhurave Vendore.

Përshëndetje të gjithëve! Paraqesim përpara jush paketën fiskale për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 paketë e cila është mbështetur mbi ligjet dhe udhëzimet përkatës në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore ligji 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” duke qenë se ne si njësi jemi përfitues të taksave kombëtare siç është renta, tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi për ndryshimin e pronësisë dhe të mjeteve të përdorura. Paketa fiskale në strukturën e vet është ndërtuar duke u mbështetur mbi taksat dhe tarifat që aplikohen nga bashkia Patos dhe të cilat trajtojnë gjerësisht në paketë. Grupi i taksave vendore, ne i kemi ndarë ato në taksa dhe tarifa.

Në taksa bëjnë pjesë

Taksa mbi ndërtesën

Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa e truallit.

Taksa e fjetjes në hotel.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Taksa e tabelës.

Ndërsa te pjesa e taksës kombëtare natyrisht ne jemi përfitues mbi bazën e përqindjeve që ka përcaktuar ligji ku ato ndahen në taksa kombëtare.

Kemi taksën vjetore të qarkullimit e mjeteve të përdorura;

taksa e rentës minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;

tatimi mbi të ardhurat personale.

Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Grupi dytë me të cilin ndërtohet paketa fiskale janë tarifavat vendore të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë paketë në të cilat bëjnë pjesë:

Tarifa e Pastrimit për Familjet.  
Tarifa e Shërbimit Komunitar.  
Tarifa e Pastrimit për Biznesin.  
Tarifa për Ndotje Mjedisi/Përmirësim Mjedisi.  
Tarifa e Gjelbërimit për Biznesin.  
Tarifa e Ndriçimit për Biznesin.  
Tarifa për zënien e hapësirave publike.  
Tarifa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme.  
Tarifa e Drejtoria e Shërbimeve.  
Tarifat për Shërbime Urbanistike  
Tarifa të propozuara nga Drejtoria Arsimore e Bashkisë  
Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit  
Tarifa e shërbimit të ujitjes  
Tarifa për linjat kabllore ajrore dhe nëntokësore.  
Tarifa për shërbimet nga administratë  
Tarifa të tjera të vendosura me ligje të veçanta.

Ajo që dua të vë në dukje është fakti se taksat dhe tarifat janë të njëjta me paketat e viteve të kaluara duke filluar që nga viti 2021. Ne kemi mbajtur një stabilitet të këtyre taksave dhe tarifave dhe për vitin 2025. Natyrisht këtu janë trajtuar dhe konceptet e këtyre taksave afatet e pagesës së tyre të cilat janë ndarë për pjesën e taksës së ndërtesës . Afatet e pagesës janë ndarë në individ dhe për biznes. Për biznes është parashikuar 30.06.2025 ndërsa për familjarët është parashikuar.30.12.2025.

Natyrisht për grupin e parë të biznesit për taksën e ndërtesës mbi bazën e përcaktimeve ligjore ka dhe kamatvonesa pas kalimit të pagesës ndaj afatit të përcaktuar që ishte 30.06 i cili në bazë të përcaktimit ligjor është 0,06% në ditë.

Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë individët familjarë.

Kemi përcaktuar strukturat përgjegjëse për vjeljen e kësaj taksë.

Kemi taksën mbi tokën bujqësore e cila është e organizuar sipas kategorive të tokave dhe përcaktimeve ligjore në këtë rast.

Afati i pagesës për tokat bujqësore është lënë 30 dhjetori. Në këtë rast kemi parashikuar dhe modalitete për të paktën njësinë Zharrëz e cila ka ulje në masën 20% të taksës nëse paguhet brenda muajit gusht të vitit 2025.

Këtu janë dhe grupet të cilët përfshihen.

Invalidët e punës e të luftës, veteranët.

Të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Për të përfutur nga përjashtimet janë përcaktuar dhe dokumentacionet përkatëse të cilat vërtetojnë përfshirjen në grupet që ne përmendëm më sipër dhe këto i kemi përcaktuar në paketën fiksale  
Kemi taksën mbi truallin e cila sikundërse te ndërtesa aplikohet për metër katror. Për individët është 0.14 lekë ndërsa për bizneset është 15.4 lekë është propozuar taksa për metër katror. Afatet kanë ngelur të njëjta ashtu siç theksuam për pjesën e ndërtesës .

Natyrisht dhe në këtë taksë individët janë përjashtuar nga pagesa e gjobës për vonesën, flasim për individët familjarë dhe janë përcaktuar dhe strukturat përgjegjëse që është Drejtoria e të Ardhurave për vjeljen e kësaj takse e cila nëpërmjet sporteleve të njësisë administrative ku janë përfaqësuesit dhe specialistët që vjelin dhe përllagarisin këto taksa.

Kemi trajtuar dhe pjesën e grupit të tarifave vendore ku kemi tarifën e pastrimit. Kategorizimi është bërë sipas biznes dhe individ në këtë rast. Tek biznesi kategorizimi është bërë mbi bazën e xhirove vjetore duke i grupuar ato në biznese të vogla të cilat nuk kalojnë kufirin prej 8 milion lekësh të xhirove vjetore dhe grupi i biznesit të madh që janë klasifikuar mbi bazën e objektit të aktivitetit që kryejnë këto biznese. Këtu përfshihen dhe kompani të cilat zhvillojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve. Për pjesën e biznesit natyrisht afati vazhdon të jetë i njëjtë sikurse për taksat dhe tarifën që është afati fundor 30.06.2025 pas të cilit apikohet një përqindje në formën e kamatës mbi detyrimin e cila sipas është 0.06 % por jo më shumë se 365 ditë kalendarike.

Përfitojnë lehtësira fiskale për tarifën e pastrimit kjo kategori:

Emigrantët të cilët do të hapin aktivitet ekonomik gjatë vitit 2025 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.

Bizneset e reja që do të hapen ku numri i të punësuarve është mbi 10.

Për persona studentë të diplomuar në Universitetet Shtetërore vendase të diplomuar gjatë vitit 2025 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.

Fermerët e paisur me NIPT janë të përjashtuar nga pagesa e tarifës.

Strukturat përkatëse për vjeljet e tarifës pastrimit janë:

Drejtoria të Ardhurave Vendore, specialisti i të ardhurave vendore pranë Njësive Administrative.  
E ardhura nga Tarifa e pastrimit i takon 100% Bashkisë.

Tarifa e Pastrimit për Familjet

Tarifat paguhen nga “çdo familje rezidente në Bashkinë Patos.

Detyrimi i tarifës është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik .

Për çdo familje të re të regjistruar gjatë vitit detyrimi llogaritet ne raport me krijimin e familjes.

Për familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të përsëritura për njësinë administrative Patos dhe nga njësitë e tjera administrative nuk banojnë në adresën e deklaruar janë të përjashtuara kjo tarifë.

Familjet pajisen me librez taksash .

Këtu janë parashikuar dhe tarifën në bazë të përbërjes familjare

Njësia Administrative Patos:

Familje e përbërë me 1 deri 2 persona e kanë këtë tarif 2,900 lekë/vit

Familje e përbërë me 3 dhe më shumë persona sipas çertifikatës familjare 4,100 lekë/vit.

Po e njëjtë është dhe për Njësinë Zharrëz.

Njësia Administrative Ruzhdie:

Fshati Ruzhdie 700 lekë/vit

Fshati Gjinoqarë 700 lekë/vit

0 lekë/vit për fshatin Drenie

## Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e Pastrimit për Familjet është vjetor.  
Afati i pagesës fundi vitit kalendarik.

Përfitojnë lehtësira fiskale për këto grupe

- Familjet e veteranëve niveli i tarifës do të jetë 0 lekë ( theksojmë nuk përfitojnë pasardhës veteranësh )
- Familjet që kanë persona me PAK niveli i tarifës do të jetë 0 lekë .
- Familjet e të përndjekurve.
- Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike do të jetë po 0
- Familjet ku janë vetëm pensionistë sipas çertifikatës familjare do të jetë po 0.

Për të përfituar nga lehtësirat fiskale:

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë sporteveve dokumentat

Librezën e veteranit ( fotokopje)

- Statusin e invalidit
- Statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë)
- Statusin e të përndjekurve politik.
- Vërtetimin nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike pranë Bashkisë, Librez e pensionit.
- Çertifikatën familjare për pensionistët e vetmuar

Janë parashikuar dhe strukturat përgjegjëse për vjeljet e kësaj tarife

Edhe te kjo tarifë individët familjarë përjashtohen nga kamtëvonesa.

**Jemi te trafifa e shërbimit komunitar** e cila paguhet nga individët rezidentë në bashkinë Patos për këtë ne i referohemi kontratave që kanë këto individë ose këto familje me OSHE detyrimin e kemi vjetor.

Për familjet e reja këtu bëhet përlllogaritja mbi bazën e kohës për familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të njëpasnjëshme nuk rezultojnë atëherë përjashtohen nga kjo tarifë. Dhe për këtë rast këto tarifa janë pjesë e librezës së taksave që pajisë bashkia Patos familjare.

Sipas Njesive tarifa e shërbimit komunitar ndahet në

Njësia Administrative Patos 700 lekë/vit

Njësia Administrative Zharëz 700 lekë/vit

Njësia Administrative Ruzhdië:

Fshati Ruzhdië 300 lekë/vit

Fshati Gjinoqarë 300 lekë/vit

Fshatrat Drenie, Kasnicë, Siqecë 0 lekë/vit.

Detyrimi për këtë lloj tarife është vjetor, afati i pagesës është viti kalendarik, fundi i vitit kalendarik.  
Natyrisht dhe këtu janë përcaktuar lehtësirat fiskale për këto grupe

- Familjet e veteranëve niveli i tarifës do të jetë 0 lekë
- Familjet që kanë persona me PAK niveli i tarifës do të jetë 0 lekë .
- Familjet e të përndjekurve
- Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike
- Familjet ku janë vetëm pensionistë sipas çertifikatës familjare

Ketu janë të njëjtat dokumenta që shprehëm pak më lart

Këto grupe duhet të dorëzojnë këto dokumenta.

- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës,( fotokopje)
- Statusin e invalidit të punës,
- Statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë,
- Stausin e të përndjekurve politik.
- Vërtetimin nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike pranë Bashkisë
- Librezë e pensionit
- Çertifikatën familjare.

Janë parashikuar dhe strukturat përgjegjëse për vjeljet e kësaj tarife

Edhe te kjo tarifë individët familjarë përjashtohen nga kamtëvonesa.

Kjo paketë fiskale për shkak të ndryshimit ligjor dhe daljes së VKM-së nr. 377, datë 12.06.2024, janë shtuar 2 trafifa që janë “Tarifë njoftim fillim punimesh qe ne e kemi ndarë për biznes dhe familje , individë në vlerën 5.000 lekë, dhe “Tarifë njoftim fillim punimesh, biznes” në vlerën 10.000 lekë.

Lori Musaj- Kryetare e komisionit të Ekonomisë - Në mbledhjen e datës 25.11.2024 gjithashtu u diskutua dhe kjo pikë kjo paketë shoqëron dhe buxhetin e vitit 2025 dhe është në mbështetje të politikave të nisura për të garantuar një zhvillim të gjatë ekonomik përpara se ta hedhim në votim dua të shpreh mendimin tim duke përgëzuar ekzekutivin e bashkisë për punën e kryer dhe duke falenderuar Kryetarin e Bashkisë për nivelin e taksave të pandryshuara. Ky projektvendim është në përputhje me ligjin dhe ftoj këshilltarët ta votojnë. Komisioni e ka votuar e tre vota pro.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projektvendim “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro **pasi është shtuar dhe këshilltari z.Gani Ahmetaj.**


SEKRETARE

Refaela Xeba




KRYETAR

Armand Ahmetaj



Lori Musaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4144/Prot.  
3

Patos më 04.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, Institucioneve në Vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2025”.

Juela Shpata – Drejtore e burimeve njerëzore -Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, miratimi i nivelit të pageve të punonjësve është e drejtë e Këshillit të Bashkisë, ndërsa që pas dhënies së këtij miratimi, miratimi i strukturës së bashkisë është e drejtë e Kryetarit të Bashkisë.

Nga ana e administratës së bashkisë është punuar për hartimin e strukturës së re të bashkisë përfshirë Njësiti Administrative, Institucionet e Varësisë dhe Funkcionet e transferuara.

Kjo strukturë është hartuar duke u mbështetur në manualin orientues “Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësiti e vetëqeverisjes vendore” dhe nevojave të institucionit tonë për të menaxhuar dhe funksionuar në mënyrë sa më efikase ndaj kërkesave të qytetarëve.

Gjithashtu e rëndësishme është të theksojmë se, numri i punonjësve të administratës nuk ndryshon për vitin që vjen. .

Në hartimin e këtij projekt vendimi janë ndjekur me përpikmëri kërkesat e legjislacionit për nëpunësin civil, të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore për nivelin e pagave për funksionet e transferuara të ndryshuar në muajin qershor dhe gusht të vitit 2024.

Bashkia Patos për vitin 2025 do të ketë një organizim me dy Zëvendës Kryetar, Sekretar të Përgjithshëm, 1 Këshilltar, 7 Drejtori, 15 Sektor, Inspektoriatin Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dhe nga dy Njësiti Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie.

Niveli i pagave duke e krahasuar me fillimin e vitit 2024 dhe projektvendimin që ne kemi kaluar në muajin shtator ka pësuar një rritje të ndjeshme. Do të jemi përsëri në të njëjtat nivele duke u bazuar në detyrat dhe funksionet e secilit punonjës.

Agjencia e Shërbimeve Publike për vitin 2025 do të ketë një organizim të tillë.

1. Sektori i Financës
2. Policia Bashkiake
3. Zëvendës Drejtor për Zhvillimin Bujqësor ku përfshihen Pyjet dhe Ujitje-Kullimi.
4. Zëvendës Drejtor për Kulturën dhe Arsimin ku përfshihet arsimi, Q.K.F, Kopshte, Çerdhe, Personeli Ndihmës dhe Klubi Shumësportësh “Albpetrol”.
5. Zëvendës Drejtor i Shërbimeve Publike ku përfshihet Sektori i Pastrim-Gjelbërimit, Sektori i Shërbimeve Publike, Sektori i Mirëmbajtjes Mekanike dhe Dekorit.

Niveli i Pagave për funksionet e transferuara për personelin edukativ, ndihmës parashkollor dhe parauniversitar si dhe Sektorin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit është sipas Vendimeve të Këshillit bashkiak për këto funksione.

Për sa më sipër ftojmë Këshillin e Bashkisë Patos që të miratojë nivelin e pagave të punonjësve të propozuara nga ekzekutivi, si të bazuara në ligj dhe në strukturimin më të përshtatshëm që i përgjigjet nevojave të institucionit tonë.

Lori Musaj – Komisioni i ekonomise konstaton se përmbajtja e projektvendimit është në përputhje me ligjin dhe e kemi votuar me 3 vota pro

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, Institucioneve në Vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2025”.


Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro .

SEKRETARE  
Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Lori MUSAJ  
Musaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4175 / Prot.  
13

Patos më 04 .12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e planit të aktiviteteve për vitin 2025, Planin e konsultimeve dhe buxhetit të këshillit bashkiak Patos për vitin 2025”.

Refaela Xeba - Kryesia e këshillit ka bërë një përmbledhje siç na e kërkon rregullorja, një përmbledhje të shkurtër të punës që bën këshilli i bashkisë gjatë vitit 2025. Të gjithë e keni marrë materialin.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “Për miratimin e planit të aktiviteteve për vitin 2025, Planin e konsultimeve dhe buxhetit të këshillit bashkiak Patos për vitin 2025”.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro .

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj